



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0619

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092), si dhe nenit 21 dhe 29 të Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020 e plotësuar dhe amendamentuar me datën 09. 08. 2023, në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së OE “Pro Medical” SH.P.K., kundër Njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje stomatologjike - Ritenderim” me numër të prokurimit 611-23-7948-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Drenas, më 17/10/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e “Pro Medical” SH.P.K. me nr. 2023/0619, e datës 25/08/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje stomatologjike - Ritenderim”, me numër të prokurimit 611-23-7948-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Drenasit.

2. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsyetimeve të dhëna nga paneli shqyrtues dhe të rregullohen afatet kohore për dorëzimin e ofertave.

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Komuna Gllogoc në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 28.07.2023 ka paraqitur Njoftimin për kontratë - B05, për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje stomatologjike - Ritenderim” me numër të prokurimit 611-23-7948-1-2-1.

Me 16.08.2023, OE "Pro Medical" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Ndërsa me 18.08.2023, AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik ankues si të pabazuar.

Operatori ekonomik "Pro Medical" i pakënaqur me Njoftimin për kontratë, me 25.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është regjistruar me numër protokolli 619/23.

- Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotësonte kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 11.09.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar,
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka njoftuar Panelin Shqyrtues se pajtohet me rekomandimet e ekspertit ndërsa Operatori Ekonomik Ankues ka njoftuar se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

Deklarimi i Ankuesit lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues: "Me datën 11.09.2023 ne OE "Pro Medical" kemi pranuar raportin e ekspertit shqyrtues Agnesë Ibrahim, me nr.2023/0619 lidhur me ankesën e parashtruar nga ne pra "Pro Medical" kundër AK – Komuna Gllogoc për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje stomatologjike – Ritenderim" me nr. të prokurimit 611-23-7948-1-2-1. Pas analizimit dhe shqyrtimit të raportit të ekspertit shqyrtues nr. 2023/0619 datës 11.09.2023, ne OE "Pro Medical" njoftojmë OSHP se ne OE "Pro Medical" nuk pajtohemi me raportin e ekspertit shqyrtues të prokurimit. Ju lutem shikoni Njoftimin e dërguar me email ne OSHP me datën 12.09.2023 me Nr. Referencë 08/2023 ku janë cekur arsyetime dhe mospajtimet tona".

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Pretendimet e Ankuesit “Pro Medical SH.P.K”

- *Pretendimi i parë (I)*- OE ankues pretendon se: “AK në DT ka kërkuar që aparati të ketë CE certifikatë dhe Raportet e testimit nën përgjegjësi për standardet IEC 60601- 1, IEC 60601-2 dhe IEC 60601-3. Pra ne kemi kërkuar nga AK që largoj vetëm pjesën Raportet e testimit nën përgjegjësi për standardet IEC 60601-1, IEC 60601-2 dhe IEC 60601-3, AK ka refuzuar. Sepse IEC është standardet IEC 60601-1, IEC 60601-2 dhe IEC 60601-3 nuk duhen kërkuar sepse IEC janë standarde kur pajisjet e caktuara duhet të plotësojnë për të certifikatave CE. Raportet e testimit nën përgjegjësi për standardet IEC 60601- 1, IEC 60601-2 dhe IEC 60601-3 nuk përkon me natyrën e këtij procesi të prokurimit, pasi standardet IEC janë të nevojshme për të siguruar certifikatën CE nga prodhuesit e pajisjeve mjekësore. Megjithatë, këto standarde nuk kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për Autoritetin Kontraktues (AK). Prandaj, AK mund të kërkojë ndoshta një (1) raport të standardit IEC 60601 dhe jo të kërkojë tri raporte. AK ka kërkuar si kërkesë e dosjes së tenderit “CE Cerficate e paisjeve “për pajisjet e kërkuara ku kjo do të mjafton dhe do ta tregoni edhe seriozitetin e natyrës së kontratës dhe do të keni ofertues me shumë potencial , ku do të gjithë ato dilemat e mundësisë favorizimit do të i largoni dhe do të keni oferta nga më shumë kompani që do të mund të furnizojnë AK.”

Konstatimet dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues

- *Konstatimi i parë (I)*- Eksperti teknik sqaron se OE ankues ka pohuar se kur Prodhuesi ka CE Certifikatë pra duhet të ketë përmbushur edhe standardet IEC 60601-1, IEC 60601-2 dhe IEC 60601-3. Pastaj ka thënë se mos kërkitimi i këtyre raporteve do të mundësojë ofertimin e më shumë OE të tjerë potencial.Kërkesa e AK-së në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për kontratë është konform rregullave dhe Ligjit për Prokurimin Publik dhe një Prodhues për t'u pajisur me CE Certifikatë duhet të plotësojë një mori standardesh, ku disa prej tyre janë edhe këto standarde të lartcekura. Pra, eksperti teknik vlerëson se pretendim i OE ankues “Pro Medical” është i pabazuar dhe propozon që të mbetet në fuqi Njoftimi për Kontratë i AK-së.

- Konstatimet e panelit shqyrtues -

Paneli shqyrtues administroi me të gjitha shkresat e kësaj lënde, duke i analizuar të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve të cilat (në përmbledhje) i shqyrtoi dhe si përfundim paneli shqyrtues do të ndalet vetëm tek pretendimi ankimor i OE, pretendim i cili përcakton dhe rrjedhën e vendimarrjes sa i përket shqyrtimit të kësaj lënde.

Pohimet ankimore të OE ankues

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar kërkesat e vendosura nga AK në njoftim për kontratë dhe DT duke pretenduar se AK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP të cituara në ankesë, ngase kundërligjshëm ka kërkuar AK në DT ka kërkuar që aparati të këtë CE certifikatë dhe Raportet e testimit nën përgjegjësi për standardet IEC 60601- 1, IEC 60601-2 dhe IEC 60601-3. Pra në kemi kërkuar nga AK që largoj vetëm pjesën Raportet e testimit nën përgjegjësi për standardet IEC 60601-1, IEC 60601-2 dhe IEC 60601-3, AK ka refuzuar. Sepse IEC është standardet IEC 60601-1, IEC 60601-2 dhe IEC 60601-3 nuk duhen kërkuar sepse IEC janë standarde kur pajisjet e caktuara duhet të plotësojnë për të certifikatave CE. Raportet e testimit nën përgjegjësi për standardet IEC 60601- 1, IEC 60601-2 dhe IEC 60601-3 nuk përkon me natyrën e këtij procesi të prokurimit, pasi standardet IEC janë të nevojshme për të siguruar certifikatën CE nga prodhuesit e pajisjeve mjekësore. Lidhur me këtë Eksperti teknik sqaron se OE ankues ka pohuar se kur Prodhuesi ka CE Certifikatë pra duhet të ketë përmbushur edhe standardet IEC 60601-1, IEC 60601-2 dhe IEC 60601-3. Pastaj ka thënë se mos kërkimi i këtyre raporteve do të mundësoj ofertimin e më shumë OE të tjerë potencial. Kërkesa e AK-së në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për kontratë është konform rregullave dhe Ligjit për Prokurimin Publik dhe një Prodhues për t'u pajisur me CE Certifikatë duhet të plotësoj një mori standardesh, ku disa prej tyre janë edhe këto standarde të lartcekura.

Për panelin shqyrtues ky konstatim i ekspertit shqyrtues nuk paraqet pasqyrim të gjendjes reale, dhe nuk paraqet asnjë provë apo mbështetje të këtij konstatimi në ndonjë dispozitë ligjore vendore apo ndërkombëtare. Detyrë e ekspertit ka qenë që të nxirret një konstatim i saktë i dispozitivit ligjorë lidhur me këto kërkesa duke ju referuar shkresave të cilat i ka pasur në dispozicion dhe të vije me një konstatim se a ka diskriminim në tek kërkesa e atakuar. Eksperti shqyrtues vjen në përfundim i cili për panelin shqyrtues nuk është konform nenit 7 të LPP i cili citon: "***mos kërkimi i këtyre raporteve do të mundësoj ofertimin e më shumë OE të tjerë potencial***". Megjithatë, paneli shqyrtues si rezultat i hulumtimit të të gjithë dokumentacionit nuk e mbështet konstatimin e ekspertit shqyrtues. Për panelin shqyrtues ky pretendim ankimor është i bazuar. Paneli shqyrtues konform nenit 70 të LPP-së ku precizohet dhe përcaktohet se në rast se autoriteti kontraktues kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura me të cilat vërtetohet përputhshmëria me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, autoriteti kontraktues do t'u referohet sistemeve për sigurimin e cilësisë që: bazohen në standardet përkatëse Kosovare, Evropiane ose ndërkombëtare dhe të certifikuara nga organet që kryejnë veprimtaritë e tyre në pajtim me ato standarde për ushtrimin e aktiviteteve të tyre të certifikimit lidhur me aktivitetet apo fushëveprimin e certifikimit. Autoriteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së. Fillimisht, përcaktimi për certifikatë CE dhe në të njëjtën kohë përcaktimi i standardit ndërkombëtar mund të sjellë konfuzion dhe kuptim ndryshe nga palët që mund të jetë në dëm të OE-ve. Pra sipas përcaktimit të mësipërm, AK duhet të përcaktohet për standarde të cilat janë të pranueshme dhe në pajtim me direktivat e BE-së. Vetëm nëse nuk ka një standard të përcaktuar me direktivë të BE-së, atëherë AK mund të kërkojë standarde ndërkombëtare. Rrjedhimisht, kërkesa e vendosur në dosje të tenderit me numër rendor 4 nuk është në pajtim me dispozitën e lartcekur. Kjo edhe në ndërlidhje me nenin 7 dhe 28 me qëllim të trajtimit të barabartë dhe dhënies së mundësisë për hapje të konkurrencës.

- Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron se një pjesë e pohimeve ankimore janë të bazuara, sikurse është shpjeguar dhe si më sipër, kurse AK nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e neneve 7, 27, 28 dhe 70 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, me fakte dhe prova dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA GLLOGOC**
- **OE - PRO MEDICAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: